

RELACION SHPJEGUES

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.152/2015 “SHËRBIMIN E MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIN”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Ky projektligj ka për qëllim përmirësimin e ligjit nr. 152/2015 “*Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin*”, duke plotësuar disa mangësi që janë evidentuar, gjatë zbatimit të tij, kryesisht në vështirësitë që janë hasur referuar zbatimit të kriterëve të pranimit për nivelet në shërbimin e MZSH-së, gjatë përzgjedhjes të punonjësve të këtij shërbimi.

Gjatë viteve të fundit, struktura e shërbimit të MZSH-së i është nënshtruar një procesi decentralizimi me qëllim përmbushjen e misionit, i cili konsiston në arritjen e ngritjes së këtij shërbimi, si strukturë e specializuar e gatishmërisë së përhershme, në çdo bashki.

Përpjekjet për të investuar në infrastrukturën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, si dhe në aftësitë dhe cilësitë njerëzore është dhe mbetet ende synimi kryesor, kryesisht në vlerat e kapaciteteve shpëtuese në raste zjarresh, fatkeqësish natyrore apo fatkeqësish të tjera.

Në kuadër të përmirësimit të nivelit të performancës së këtij shërbimi, si dhe të objektivave për zbatimin e politikave të veprimtarisë së shërbimit të MZSH-së, qëllimi për rritjen dhe garantimin e sigurisë publike nga rreziku i zjarrit në territorin e bashkisë, synohet të realizohet nëpërmjet ndryshimeve si dhe angazhimit maksimal në përmbushjen e detyrimeve të legjislacionit sektorial dhe akteve nënligjore në zbatim të tij për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin.

Ndryshimet e ardhshme ligjore promovojnë faktin se, rekrutimi i personelit cilësor në strukturat vendore të shërbimit të MZSH-së është me rëndësi për zhvillimin e mëtejshëm të burimeve njerëzore për strukturën e shërbimit zjarrfikës.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTEVE TË TJERA POLITIKE

Ky projektligj është parashikuar në programin e përgjithshëm analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave, për vitin 2022, për Ministrinë e Brendshme.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Ndryshimet e pritshme të ligjit nr. 152/2015 synojnë të arrijnë objektivat për një menaxhim sa më të suksesshëm të burimeve njerëzore në strukturën e shërbimit të MZSH-së, si dhe vlerësohet se duhet të zhvillohen e përmirësohen duke u përqëndruar në këto objektiva kryesorë si:

- a) krijimi i standardeve për pranimin e punonjësve të rinj për të rritur cilësinë në strukturën e shërbimit të MZSH-së, duke përmirësuar ndërkohë procedurat dhe praktikat e procesit të pranimit, por edhe duke mundësuar për plotësimin e nevojave, nëpërmjet pranimeve në shërbimin e MZSH-së të ushtarakëve aktivë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, si dhe punonjësve të strukturave të Policisë së Shtetit. Kalimi nga strukturat operacionale të Forcave të Armatosura dhe të Policisë së Shtetit tek strukturat vendore të shërbimit të MZSH-së do të realizohet duke njohur vjetërsinë e shërbimit në këto struktura, për efekt gradimi.
- b) sigurimi i një sistemi të drejtë, transparent dhe të barabartë për menaxhimin e karrierës lidhur me emërimin, vlerësimin dhe ecurinë në gradë e karrierë.
- c) rritja e moshës së pranimit të punonjësve operacionale, pra për nivelin bazë të këtij shërbimi nga 30 në 35 vjeç, si dhe përcaktimi i moshës për punonjësit e nivelit të mesëm nën moshën 50 vjeç;
- d) promovimi i shërbimit vullnetar të mbrojtjes nga zjarri.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”” i propozuar nga Këshilli i

Ministrave është në përputhje të plotë me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe në harmoni me legjislacionin vendas.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin””, nuk synon përafrimin me *acquis communautaire* të Bashkimit Evropian, ndaj edhe nuk ka vlerësim të shkallës së përafrimit.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Disa nga çështjet kryesore që rregullon projektligji i paraqitur në mënyrë të përmbledhur janë:

Neni 1 përcakton se:

Në nenin 7, pika 2 ndryshon si më poshtë vijon:

“2. Drejtoria e Përgjithshme e MZSH-së është institucion varësie, person juridik, publik, në varësi të ministrit. Struktura dhe organika e Drejtorisë së Përgjithshme miratohet me urdhër të Kryeministrit me propozim të ministrit”.

Neni 2 përcakton se:

Në nenin 13, shtohet pika 3, si vijon:

“3. Këshilli bashkiak, me propozim të kryetarit të bashkisë miraton pagesën e shpenzimeve të nevojshme për kryerjen e vullnetarizmit, për punonjësit e shërbimit vullnetar zjarrfikës.”

Kjo shtesë bëhet për të mundësuar mirëfunksionimin dhe nxitjen e shërbimit vullnetar, që ka përgjegjësi për administrimin e pasurive shtetërore me rrezikshmëri nga zjarri, si një mbështje e domosdoshme e strukturave të mbrojtjes nga zjarri në territor. Krahas parashikimeve ekzistuese në ligj mbi shërbimin vullnetar të MZSH-së dhe mundësisë për rritjen profesionale të tij përmes

programeve të përgatitjes profesionale dhe mësimëve treguese për dhënien e njohurive të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, në projektligj është shtuar një pikë e caktuar që parashikon se këshilli bashkiak, me propozim të kryetarit të bashkisë miraton pagesën e shpenzimeve të nevojshme për kryerjen e vullnetarizmit, për punonjësit e shërbimit vullnetar zjarrfikës.

Ky përcaktim është parashikuar në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, i cili në nenin 54 (Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak), shkronja ç), parashikon se këshilli bashkiak miraton nivelin e pagave e të shpërblimeve të punonjësve e të personave të tjerë, të zgjedhur ose të emëruar, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Gjithashtu, ligji nr. 45/2016 “Për vullnetarizmin” parashikon në nenin 4 (Vullnetarizmi), pika 2 se: “Vullnetarizmi kryhet pa pagesë, pa kompensim ose ndonjë përfitim tjetër material, përveç rasteve kur ky ligj parashikon ndryshe.” Ndër të tjera, në nenin 21 (Përgjegjësitë e ofruesit të vullnetarizmit), pika 1, shkronja dh) parashikon se ofruesi i vullnetarizmit ka për detyrë që t’i sigurojë vullnetarit pagesën e shpenzimeve të nevojshme për kryerjen e vullnetarizmit, si shpenzime transporti, shpenzime trajnimi, shpenzime ushqimi, si dhe çdo shpenzim tjetër që përcaktohet në kontratën e vullnetarizmit.

Si rezultat i kësaj shtese synohet promovimi i vullnetarizmit në strukturat e shërbimit të MZSH-së i cili është jashtëzakonisht i rëndësishëm në forcimin e kapaciteteve për grupet zjarrfikëse që operojnë në territorin e bashkive respektive.

Neni 3 përcakton se:

Në nenin 14 bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë vijojnë:

1. Në pikën 1, në shkronjën e), togfjalëshi “nën 30 vjeç” zëvendësohet me “nën 35 vjeç” .

2. Në pikën 1, shtohet shkronja “f”, si vijon:

“f) të jetë i/e moshës nën 40 vjeç, shtetasi që ka përvojë në strukturat operacionale të Forcave të Armatosura ose të Policisë së Shtetit dhe ka më pak se dy vjet shkëputje të marrëdhënieve të punës nga këto struktura. Këshilli i Ministrave përcakton me vendim ekuivalentimin e gradave të Forcave të Armatosura dhe të Policisë së Shtetit me gradat e strukturës së MZSH-së”.

3. Në pikën 2 shtohet shkronja “dh”, si vijon:

“dh) të jetë i/e moshës nën 50 vjeç”.

4. Në pikën 3, në shkronjën “b”, togfjalëshi “jo më pak se 10 vjet” zëvendësohet me “jo më pak se 5 vjet”.

5. Pika 4 ndryshon si më poshtë vijon:

“4. Për nivelin madhor konkurron shtetasi që plotëson kërkesat e pikës 3, të këtij neni, ka punuar në nivelin e lartë të shërbimit të MZSH-së jo më pak se 5 vjet dhe mban gradën maksimale për nivelin e lartë ose ka përvojë pune jo më pak se 10 vjet në kategorinë e lartë drejtuese në institucionet e administratës publike apo në rolin e mesëm drejtues në Policinë e Shtetit dhe nuk ka masa për shkelje të rënda disiplinore brenda 3 vjetëve të fundit”.

Në nenin 14 të ligjit janë bërë ndryshimet dhe shtesat e mësipërme pasi gjatë zbatimit të ligjit aktual janë hasur vështirësi në aplikimin e kriterëve të pranimit të përcaktuara dhe shpesh herë janë vënë në vështirësi autoritetet si ministri përgjegjës për hartimin e politikave, koordinimin dhe mbikëqyrjen e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, kryetari i bashkisë dhe drejtori i përgjithshëm, referuar detyrimeve ligjore të tyre mbi emërimin e personelit të MZSH-së, lidhur me rekrutimet e punonjësve në nivelet e këtij shërbimi, kryesisht niveli i mesëm dhe i lartë, ku vështirësia konsiston kryesisht në mosplotësimin e kriterit “vjerërsi” në strukturën e shërbimit zjarrfikës.

Ndryshimet e propozuara konsistojnë në uljen e këtyre kriterëve dhe ripërcaktimin e kriterëve për nivelin madhor me qëllim rritjen e konkurrencës dhe të vlerave të meritokracisë në përgjedhjen e punonjësve të shërbimit të MZSH-së.

Konkretisht në projektligj, kriteri i pranimit për nivelin e lartë, referuar përvojës së punës në nivelin e mesëm në strukturat e shërbimit MZSH-së ulet nga 10 vjet në 5 vjet, pra punonjësi që të kalojë nga niveli i mesëm në atë të lartë duhet të ketë punuar në nivelin e mesëm në strukturat e shërbimit MZSH-së jo më pak se 5 vjet, krahas kriterit aktual për të mbajtur gradën maksimale të nivelit të mesëm. Gjithashtu, është ndryshuar parashikimi mbi kriteret që duhet të plotësojë shtetasi i cili konkurron për nivelin madhor (që përkon me gradën “Drejtues i lartë zjarrfikës”), që përkon me një funksion menaxherial të shërbimit të MZSH-së, i

cili krahas kritereve të përcaktuara në pikën 3 të nenit 14 duhet të plotësojë në mënyrë kumulative edhe:

1. Ka punuar në nivelin e lartë të shërbimit të MZSH-së (që përkon me gradat “Drejtues zjarrfikës”; “Drejtues i parë zjarrfikës”) jo më pak se 5 vjet;

2. Mban gradën maksimale për nivelin e lartë (që përkon me gradën “Drejtues i parë zjarrfikës”). OSE

1. Ka përvojë pune jo më pak se 10 vjet në kategorinë e lartë drejtuese në institucionet e administratës publike (referuar ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në nenin 19 “Klasifikimi”, në pikën 4 parashikon se nëpunës civilë të kategorisë së lartë drejtuese janë pozicionet si sekretar i përgjithshëm; drejtor departamenti; drejtor drejtorie të përgjithshme dhe pozicionet e barasvlershme me tre të parat); apo në rolin e mesëm drejtues në Policinë e Shtetit (referuar ligjit 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” i ndryshuar, neni 50/1 “Hierarkia e menaxhimit policor”, shkronja c) pa arashikon se në rolin e mesëm drejtues, përfshihen punonjësit e policisë që mbajnë gradën “Drejtues” dhe “Drejtues i parë”, që përfaqësojnë nivelin e menaxhimit ekzekutiv qendror dhe/ose vendor);

2. Nuk ka masa për shkelje të rënda disiplinore brenda 3 vjetëve të fundit.

Neni 4 përcakton se:

Në nenin 25 bëhen ndryshimet dhe shtesat si vijon:

1. Në pikën 1, në shkronjën e), pikat “i”, “ii”, “iii”, “iv”, “v”, “vi”, riformulohen si vijon:

- | | |
|---|---------|
| i) nga “Asistent zjarrfikës” në “Zjarrfikës” | 3 vite; |
| ii) nga “Zjarrfikës” në “Kryezjarrfikës” | 4 vite; |
| iii) nga “Inspektor zjarrfikës” në “Kryeinspektor zjarrfikës” | 3 vite; |
| iv) nga “Kryeinspektor zjarrfikës” në “Komisar zjarrfikës” | 4 vite; |
| v) nga “Komisar zjarrfikës” në “Drejtues zjarrfikës” | 4 vite; |
| vi) nga “Drejtues zjarrfikës” në “Drejtues i parë zjarrfikës” | 3 vite. |

2. Shtohet pika 4 si vijon:

“4. Punonjësit që ka punuar në strukturat operacionale të Forcave të Armatosura dhe të Policisë së Shtetit i njihet vjetërsia e shërbimit në këto struktura për efekt gradimi”.

Pra, ndryshimet konsistojnë në uljen e viteve të qëndrimit në gradë, për tu dhënë më shumë mundësi punonjësve të të gjitha niveleve të rriten në karrierë dhe të promovohen në detyrë, brenda strukturës si në nivel vendor apo qendror.

Neni 5 përcakton se:

Në nenin 41, pika 1 ndryshon si vijon:

“1. Shërbimi vendor i MZSH-së në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse për urbanistikën në bashki miraton projektin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin që shoqëron dokumentacionin tekniko-ligjor të lejeve të zhvillimit e lejeve të ndërtimit në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, nëpërmjet një komisioni të posaçëm.

Komisioni ngrihet me urdhër të kryetarit të bashkisë dhe ka në përbërje anëtarë nga shërbimi vendor i MZSH-së, të nivelit të mesëm dhe punonjës të strukturës përgjegjëse për urbanistikën”.

Ky përcaktim është parashikuar me qëllim garantimin e transparencës dhe integritetit të vendimmarrjes së shërbimit vendor të MZSH-së mbi miratimin e projektit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, në bashkëpunim me strukturën përgjegjëse për urbanistikën në bashki, në mbështetje edhe të parimit të bashkëpunimit referuar ligjit nr. 90/2012 “*Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore*” i cili në nenin 24 ndër të tjera parashikon se institucionet e administratës shtetërore bashkëpunojnë me njëri-tjetrin dhe me institucionet e tjera shtetërore e me njësitë e qeverisjes vendore në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 6 përcakton se:

Në nenin 46, pika 2 shfuqizohet.

Në kuadër të përmirësimit të veprimtarisë të shërbimit të MZSH në nivel vendor dhe mangësi të konstatuara në përzgjedhjen e punonjësve të inspektimit për mbrojtjen nga zjarri dhe shërbimin del domosdoshmëri ndryshimi i nenit 46, i cili konsiston në shfuqizimin e pikës 2, me synim heqjen e kriterit të vjetërsisë jo më pak 5 vjet, duke pasur si qëllim rritjen dhe bërjen atraktive të konkurrencës brenda shërbimit të MZSH-së.

Neni 7 përcakton se:

Në nenin 49, shtohet pika 5 si vijon :

“5. Drejtoria e Përgjithshme e MZSH-së jep autorizim për personat fizikë dhe juridikë, vendas dhe të huaj për importin, eksportin, tregtimin, instalimin, mirëmbajtjen e fikseve të zjarrit dhe sistemeve stacionare në bazë të kritereve të miratuara me udhëzim të ministrit”.

Kjo pikë shtohet në nenin 49 me qëllim standardizimin dhe mirëmbajtjen e aparateve të lëvizshme për fikjen e zjarrit.

Neni 8 përcakton se:

Në nenin 50, në pikën 2, shkronjat “a”, “b” dhe “ç” riformulohen si vijon:

- “a) për shkelje të nenit 38, dënim me gjobë, në masën 5 000 deri 20 000 lekë;
- b) për shkelje të nenit 39, dënim me gjobë, në masën nga 5 000 deri në 10 000 lekë;
- ç) për shkelje të neneve 42 e 43, dënim me gjobë, në masën nga 20 000 deri në 50 000 lekë”.

Ndryshimi konsiston në uljen e masës së sanksionit administrativ (gjobës), pasi struktura e MZSH në nivel vendor evidenton se marzhet janë tepër të larta, në raport me nivelin e të ardhurave. Referuar statistikave mujore që dërgon shërbimi i MZSH-së, rezulton se aplikohen pak ose aspak gjopa nga inspektorët vendorë, përtej shkeljeve të dukshme të subjekteve juridikë dhe fizikë lidhur me detyrimet e marrjes së masave të mbrojtjes nga zjarri të përcaktuara në ligjin nr. 152/2015.

Neni 9 përcakton se:

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij ligji ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e MZSH-së, ministrin përgjegjës për hartimin e politikave, koordinimin dhe mbikëqyrjen e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin e njësitë e vetëqeverisjes vendore.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky projektligj është hartuar nga grupi i punës, i kryesuar nga zëvendësministri i Brendshëm, në zbatim të urdhrit nr. 139, datë 26.07.2022 të ministrit të Brendshëm *“Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin””*.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektakt nuk parashikon efekte financiare në buxhetin e shtetit.

MINISTRI

BLENDAR ÇUÇI